



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO
KOSOVA E SHTITES-REPUBLIKA STIMILJE
Nr i Protokollit Prot 021/195
Nr i Faqeve/Strana _____
Data/Dana: 21.11.2025
SHTIME/STIMILJE

21/11/2025
02/1319

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOV. KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT-MINISTARSTVO KULTURE
YOUTH AND SPORTS-MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
Nr. Njes. 02 Shenja klas. 03
Nr. Protokolli 61941/2025
Data 25.11.2025
Nënshkrimi Aliu
Prishtine

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sports

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Për mbështetje dhe investim në pajisjen (inventarizimin) e objektit komunal - Shtëpia e Përshpëritshme në Shtime, monument në Listën e Aseteve të Trashëgimisë Kulturore në Mbrotjtje të Përkohshme me numër unik 4200.

Neni 1
Palët kontraktuese

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

1. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Bislim Bislimi, në cilësinë e financuesit dhe mbështetësit të projektit

dhe

2. Komunës së Shtimes, me seli në Shtime, e përfaqësuar nga Kryetari z. Qemajl Aliu, në cilësinë e pronarit të objektit dhe bashkëimplementuesit të projektit.

Neni 2
Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që MKRS të marrë përsipër investimin në pajisjen me inventar të objektit komunal të lartpërmendur, me qëllim të funksionalizimit të plotë të tij në ofrimin e kushteve dhe hapësirë për komunitetin e kulturës, rinisë dhe sportit në Shtime, në përputhje me destinimin e objektit.

Neni 3

Objekti i investimit

Objekti i kësaj marrëveshjeje përfshin:

- Pajisjen e objektit me inventar sipas listës teknike të aprovuar nga palët;
- Mbështetjen financiare për blerjen, transportin dhe vendosjen e inventarit;
- Sigurimin që investimi të kryhet në pajtim me standardet teknike dhe administrative në fuqi.

Neni 4

Obligimet e MKRS

MKRS merr përsipër që:

1. Të sigurojë financimin e nevojshëm për realizimin e investimit në përputhje me buxhetin e aprovuar për këtë projekt në shumë totale prej 120,000.00€ (një qind e njëzet mijë euro) që do të sigurohet nga kodi 81500 dhe 81600, linja Mallërat e Shërbimet. Ndarja buxhetore në periudha kohore do të jetë si vijon:
 - 1.1. 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro) për vitin 2025,
 - 1.2. 70,000.00 € (shtatëdhjetë mijë euro) për vitin 2026.
2. Të mbikëqyrë dhe monitorojë zbatimin e investimit përmes Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor Ferizaj.
3. Të dorëzojë inventarin në mënyrë zyrtare Komunës pas përfundimit të projektit.

Neni 5

Obligimet e Komunës

Komuna merr përsipër që:

1. Të sigurojë objektin për të cilin realizohet investimi dhe të garantojë se ai është pronë komunale e regjistruar;
2. Të sigurojë kushtet teknike dhe ligjore për zbatimin e projektit;
3. Të mirëmbajë inventarin pas dorëzimit dhe të përdorë objektin për qëllimet për të cilat është destinuar;
4. Të raportojë tek MKRS për funksionalizimin e objektit dhe përdorimin e mjeteve.

Neni 6

Afati i zbatimit

Zbatimi i projektit parashihet të realizohet brenda periudhës kohore 2025-2026.

Neni 7
Mbikëqyrja dhe raportimi

Palët do të caktojnë nga një përfaqësues përgjegjës për monitorimin dhe koordinimin e aktiviteteve të projektit, të cilët do të bashkëpunojnë në çdo fazë të realizimit dhe raportimit financiar/teknik.

Neni 8
Të drejtat e pronësisë

Pas përfundimit të investimit, i gjithë inventari do të mbetet pronë e Komunës përkatëse, ndërsa MKRS ruan të drejtën e inspektimit dhe verifikimit të përdorimit të tij për periudhë prej pesë (5) vitesh.

Neni 9
Përfundime

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët dhe është e vlefshme deri në përmbylljen e obligimeve të përcaktuara. Çdo ndryshim apo plotësim i kësaj marrëveshjeje bëhet vetëm me marrëveshje të shkruar ndërmjet palëve.

Nënshkruar në Prishtinë, më datë 21 / 11 / 2025

Për MKRS:


Bislim Bislimi
Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

Për Komunën e Shtimes:


Qemal Aliu
Kryetar i Komunës së Shtimës